



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI

Sesioni vjeshtor
Komisioni për Legjislacion, Mandate,
Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen
e Agjencisë Kundër Korrupsionit
Mbledhja nr. 02
Prishtinë, më 17.10.2017, në orën 13:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla –S 1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Albulena Haxhiu, Hajdar Beqa, Bahrim Shabani, Korab Sejdiu, Shkumbin Demaliaj dhe Bilall Sherifi.

Munguan: Glauk Konjufca, Sami Kurteshi, Arben Gashi, Agim Aliu, dhe Jelena Bontiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Gresa Ramadani dhe Gresa Smolica, Lëvizja Vetëvendosje; Gzim Shala, IKD/BPD; Sani Berisha, OSBE; Behxhet Shala, KMDLNJ; Alajdin Rexhepi KDI; Agim Maraj, BritishEmbassy; Dren Ajeti, GLPS; Ramadan Gashi dhe Feim Osmani, ANJF; Shaip Havolli dhe Blerim Kelmendi, AKK; Qendresa Leku dhe Rinor Beka, NDI; dhe Basri Berisha, zëvendës Avokati i Popullit.

Mbledhjen e kryesoi, Albulena Haxhiu, kryetare e komisionit.

Nga stafi mbështetës: Visar Krasniqi, Mirlinda Kolgeci dhe Fatbardha Boletini.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Diskutim lidhur me planin e punës së komisionit.
3. Propozimi i anëtarit në Komisionin Qeveritar për njohjen e statusit të ish të dënuarve dhe ish të përndjekurve Politikë;
4. Diskutim lidhur me zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
5. Formimi i grupit punues për rregulloren e Kuvendit;

6. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit;
7. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit për vitin 2016;
8. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2016;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me ndryshime duke zhvendosur pikat 7 dhe 8, pas pikës së parë. Po ashtu te pika të ndryshme diskutim për ftesë të ministrit të Drejtësisë për të raportuar me në lidhje për zbatimin e ‘Marrëveshjes për Drejtësi’. Pika 4 diskutim lidhur me zgjedhjen e tre anëtarëve të Këshillit Prokurorial të Kosovës shtyhet për një mbledhje tjetër.

2. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë Kundër Korrupsion për vitin 2016

Kryetarja në fjalën e saj ftoi drejtorin e Agjencisë Kundër Korrupsion, z. ShaipHavolli, për të raportuar para anëtarëve të komisionit.

ShaipHavolli i njoftoi komisionin me të arriturat dhe sfidat që ka ky institucion. Sa i përket deklaramit të dhuratave u tha se 11 institucione kanë deklaruar dhuratat, ndërsa 36 institucione të tjera nuk janë deklaruar. Për fushën e prokurimit publik janë identifikuar 127 raste të cilat janë monitoruar nga AKK-ja, nëse ka pasur shkelje të prokurimit publik. Më tej u tha se sa i përket konfliktit të interesit janë 210 raste, 90 raste i janë shmangur konfliktit të interesit, 1 rast është përcjellë për hetime penale, ndërsa 1 rast është iniciuar në kundërvajtje. Në vazhdim u përmend edhe çështja e monitorimit të Strategjisë Kundër Korrupsion, ku tha se deri në fund të këtij viti janë përmbytur 70% të aktiviteteve të institucioneve. Z. Havolli foli edhe për çështjet legislative dhe tha se ligji për konflikt të interesit është hartuar dhe është përcjellë në Kuvend, ndërsa Ligji për Deklarimin dhe Prejardhjen e Pasurisë është koncept dokument dhe i është përcjellë Ministrisë së Drejtësisë për debat publik. Kurse duke folur rreth deklaramit të pasurisë tha se për deklarim të pasurisë obligim kanë pasur 4.352 zyrtarë, ndërsa deklarim kanë bërë 4.334, ku ndaj 18 zyrtarëve të lartë është ushtruar kallëzim penal për mos deklarim të pasurisë. Më tutje tha se është e nevojshme ndryshimi dhe plotësimi i ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit.

Kryetarja pyeti në lidhje me deputetë e rinj që kanë qenë anëtarë të kompanive, bordeve e agjencive, se çfarë është duke bërë Agjencia Kundër Korrupsion për ta trajtuar konfliktin e interesit të deputetëve të Kuvendit, që janë zyrtarë të lartë, por po ashtu edhe të kabinetit qeveritar, d.m.th. këta deputet a kanë hequr dorë nga puna e tyre e ushtruar më parë? Pse konsideroni që ka pasur rënie drastike të rasteve të iniciuara në prokurori, në raport me vitin 2015? Po ashtu shqetësim i znj. Haxhiu ishte parashkrimi i veprave penale duke thënë se si e shpjegoni ju punën e policisë, prokurorisë në raport me rastet e iniciuara? Çfarë po bëni në lidhje me edukimin e zyrtarëve të lartë, të cilët kanë shumë probleme me plotësim të formularëve të

deklarimit të pasurisë? Ju keni kërkuar krijimin e një trupi koordinues të përbashkët për të gjitha institucionet që merren me luftën ndaj krimit të organizuar dhe korrupsionit, d.m.th. si e keni menduar këtë? Po ashtu 30 % e institucioneve që e dashur të raportojnë nuk kanë raportuar, si e keni menduar këtë strategji që jeni duke përpiluar për vitin 2017-2022? Gjithashtu a keni qenë të përfshirë në hartimin e projektligjit për konfliktin e interesit dhe sa prej rekomandimeve tuaja janë përfshirë në projektligj?

Shaip Havolli duke ju përgjigjur pyetjeve tha se në lidhje me konfliktin e interesit të deputetëve të rinj, të gjithë deputetët kanë deklaruar pasurinë e tyre dhe bazuar në informacionet e kësaj deklarate të pasurisë në fillojmë me trajtimin e çështjes së konfliktit të interesit, jo vetëm për deputet, por edhe për zyrtarë të tjerë. Sa i përket rënies së kallëzimeve penale, siç e dini Agjencia ka mandat administrativ dhe me dyshim të arsyeshëm mund të dërgojë kallëzim penal në prokuroritë përkatëse, prandaj edhe kemi qenë më të kujdesshëm rreth kallëzimeve penale që provat materiale të jenë më bindëse në mënyrë që mos të penalizohet asnjë zyrtar i lartë. Ndërsa te parashkrimi i veprave penale, është e vërtetë që shumica e kallëzimeve penale parashkruhen gjatë punës së prokurorisë, e cila arsyetohet se ka mungesë të kapaciteteve dhe aty këtu ndonjë neglizhencë e punës së prokurorisë. Duke folur për rastet e 2017 z. Havolli thotë se ka informacion se të gjitha rastet që janë dërguar në prokurori, hetimet kanë filluar, por nuk do të thotë që të gjitha mund të kalojnë në aktakuzë, sepse prokuroria ka të drejtë të kërkojë prova shtesë, qoftë nga Agjencia e policia, por edhe vetë sipas detyrës zyrtare të fillojë hetimet. Në lidhje me edukimin e zyrtarëve të lartë për të plotësuar formularin e deklarimit të pasurisë tha se në zhvillojmë fushata 3 ditë apo 4 ditë rresht, japim instruksione ose nëse dikush nga zyrtarët has në vështirësi për plotësuar formularin, ne mund t'i ofrojmë vetë ndihmë sepse vërtet shumë zyrtarë kanë problem të plotësojnë formularin. Ndërsa sa i përket trupit të përbashkët tha se mekanizmat antikorrupsion si agjencia, prokuroria, drejtoria për krime ekonomike, task forca, njësia e inteligjencës financiare, hetimet në doganë, hetimet në administratën tatimore, duket sikur e kanë shpërndarë përgjegjësinë e trajtimit të lëndëve të korrupsionit, kështu që kam kërkuar që në ardhmen të ketë një trup të përbashkët që ta ketë primatin e trajtimit të lëndëve të korrupsionit sepse me ligj dihet që është policia dhe prokuroria. Duke folur për strategjinë z. Havolli theksoi se shoqëria civile dhe mediat nuk do të jenë pjesë e raportimit të aktiviteteve, por kemi kërkuar që të jenë pjesë e monitorimit. Gjithashtu në projektligjin për Konfliktin e Interesit kemi dhënë kontribut gjatë hartimit si Agjenci sepse Agjencia ka pasur situata praktike të cilat i ka hasur gjatë punës për konfliktin e interesit. Rekomandimet që i ka dhënë Agjencia, por edhe Këshilli i Evropës janë marrë parasysh në këtë projektligj.

Hajdar Beqa tha se ky raport është një raport i mirë edhe pse nuk prodhon ndonjë efekt përveç informimit, por është obligim i yni që ta procedojmë në seancë plenare. Z. Beqa theksoi se puna e Agjencisë nuk matet sa kallëzime penale i bën, sepse më profesionale do ishte t'i bënte agjencia pesë kallëzime penale, e tre prej tyre të kenë elemente të kryerjes së veprës penale, duke pohuar që të prodhojmë rezultate konkrete në luftën kundër korrupsionit dhe lufta nuk bëhet vetëm duke bërë kallëzime penale, por të përmbajnë prova, ndaj zvogëlimin e numrit e shoh më shumë si

profesionalizëm. Z. Beqa pyet se kallëzimet penale kur janë bërë, a kanë qenë jo profesionale apo nuk ka pasur elemente të veprës penale dhe çfarë masash merr Agjencia që kallëzimet penale kur të shkojnë në prokurori të jenë më të kompletuara dhe a i keni zyrtarët profesional në fusha të caktuara?

Shaip Havolli theksoi se në Agjenci vijnë informacione të ndryshme, të cilat i kemi vlerësuar se nuk kanë, as elemente të veprës penale, por as shkelje administrative, ndaj ka edhe mbyllje të hetimeve. Po ashtu tha se agjencia ka staf profesionist në fushën vet të hetimeve dhe të gjitha kallëzimet penale dhe në shumë situata në konsultohemi me prokuroritë përkatëse kur kemi raste që ka elemente të mjaftueshme të veprës penale edhe pse ligji na e lejon që të bëjmë hetime paraprake pa e njoftuar prokurorin.

Shkumbin Demaliaj tha se integrimi jonë në BE duket se është i pamundur dhe themeltar pikërisht në këtë fushë duke pohuar se në gjitha raportet e progresit thuhet se duhet të eliminohet kjo dukuri e korrupsionit dhe se a e keni mbështetjen e shtetit, e për ti kryer punët tuaja edhe nga ana financiare, por edhe a jeni të mbrojtur.

Shaip Havolli tha se për sa kohë që jam drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsion nuk kam pasur asnjë lloj problemi nga asnjë zyrtar i lartë, ndërsa sa i përket anës financiare agjencia për momentin nuk ka burime të mjaftueshme financiare, por edhe staf të mjaftueshëm për arsye se pritet një riorganizim i saj me ndryshim -plotësimin e ligjit.

Bilall Sherifi tha se çështja e agjencisë është një mekanizëm që mes publikut dhe pritjeve të mundësive gjithmonë ka probleme, sepse agjencia e ka rolin kryesor për të luftuar korrupsionin dhe unë e shoh si adresën e parë për denoncim të korrupsionit, shtoi z. Sherifi. Agjencia kryen dhe vazhdon të kryejë detyrën e saj dhe funksionin e saj sensibilizues të luftës kundër korrupsionit duke pohuar se fakti që një zyrtar i lartë e merr seriozisht deklarin e pasurisë duket që ka rezultat. Në fund z. Sherifi tha se ju inkurajoj të vazhdoni të bëni punën ashtu si e keni bërë, të merrni denoncimet dhe t'i procedoni më tej dhe të gjithë së bashku përmes ligjit të ndërtojmë një sistem të besueshëm që lufton korrupsionin.

Korab Sejdiu tha se mungesa e punës së prokurorisë për t'i proceduar rastet më tej është ajo që ju kufizon në luftën kundër korrupsionit. Z. Sejdiu pyet se a keni menduar që të kërkonin nga Ministria e Drejtësisë që përmes kodit të procedurës penale të fusë edhe mundësinë e ndjekjes ose padisë supsidiale, po ashtu nuk është e domosdoshme deklarimi i pasurisë, por prejardhja e saj dhe sa jeni ju të angazhuar për ta realizuar misionin që e keni dhe çfarë hapash po merrni në këtë drejtim?

Shaip Havolli tha se agjencia ka mision të parandalimit, edukimit, hetimit, por merret edhe me disa çështje të tjera të cilat i takojnë me ligj dhe me ligjin e ri do rregullohen disa situata për të cilat kemi qenë konfuz. Ndërsa sa i përket hedhjes së kallëzimit penal, prokurori ka të drejtë ta hedh poshtë kallëzimin penal sepse e ka mandatin. Sa i përket prejardhjes së pasurisë, agjencia ka mandat administrativ, mirëpo mjafton që zyrtarët ta deklarojnë pasurinë sepse nëse fillon

hetim penal mund të vinë ta marrin deklaratën e pasurisë që nga 2007-2008, kur ka filluar të deklarojë pasurinë dhe kjo është një bazë e mirë për prokurorinë dhe policinë se sa ka pasur zyrtari pasuri kur ka filluar punën në institucione. Kjo ka të bëjë me transparencë, llogaridhënie para shoqërisë civile dhe para qytetarëve.

Kryetarja pyet se a ka pas ndonjë trajnim të zyrtarëve për ta ushtruar këtë punë për shkak se nëse hyn në fuqi ligji për konfliktin e interesit zyrtarët nuk do të dinë se si të veprojnë. Çfarë kërkon ju saktësisht me ndryshimi ligjore që të fuqizohet roli i Agjencisë Kundër Korrupsionit?

Shaip Havolli tha se ne, si agjenci, jemi duke i bërë përgatitjet se si të veprohet kur të hyjë në fuqi ky ligj dhe kryesisht do të merren zyrat ligjore të institucioneve se si të zbatohet ky ligj. Në takimit që kemi pasur kemi kërkuar që me ligjin e ri ne, si agjenci, të kemi mandat që në fazën fillestare të konsultohemi ose të marrim autorizimin nga prokurori.

Hajdar Beqa theksoi se shqetësimi kryesor është te deklarimi publik, duke pohuar se duhet të bëjmë deklarimin e pasurisë, por të kenë qasje organet përkatëse dhe jo të ketë qasje kushdo.

Pas diskutimeve, *kryetarja konstatoi se komisioni me 5 vota për dhe 1 abstenim vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti i Punës së Agjencisë kundër Korrupsionit për vitin 2016.

3. Shqyrtimi i raportit vjetor i punës së Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas për vitin 2016

Kryetarjaftoi drejtorin e Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas që të paraqesë raportin e punës për vitin 2016.

Ramadan Gashitha se Ndihma Juridike Falas është kategori Kushtetuese dhe sipas nenit 31, paragrafi 6 definohet se “Ndihma Juridike falas do t’u mundësohet atyre që nuk kanë mjete të mjaftueshme financiare, nëse një ndihmë e tillë është e domosdoshme për të siguruar qasje efektive në drejtësi. Fillimisht Ndihma Juridike falas është dhënë deri në vitin 2006 nga Agjencia Evropiane për Rindërtim, ku ka qenë nga një zyrtar për çdo komunë. Më pas është formuar Komisioni për Ndihmë Juridike Falas, që ka funksionuar në pesë zyra. Po ashtu, në vitin 2012 është nxjerrë ligji për Ndihmë Juridike Falas, me ç’rast është themeluar Agjencia për Ndihmë Juridike Falas, e cila ka funksionuar me vetëm pesë zyra dhe më vonë me një program të UNDP-së, me qëllim të shtrirjes së ndihmës juridike falas në tërë territorin e Republikës së Kosovës, u hapën 8 zyra në komuna të ndryshme, deri më 30 qershor 2015. Ndërsa, që nga prilli i vitit 2017 janë rihapur edhe dy zyra për ndihmë Juridike Falas në Ferizaj dhe në Gjakovë, pasi që Kuvendi i

Kosovës aprovoi kërkesën buxhetore për rihapjen e dy zyrave rajonale për Ndhimë Juridike Falas, në Ferizaj dhe në Gjakovë.

ANJF-ja përmes mekanizmave të saj ka ofruar ndihmë juridike falas, në katër fusha kryesore; në fushën penale, civile, kundërvajtje dhe në fushën administrative.

Gashi theksoi se për shkak të buxhetit të limituar që kemi në lëmin penale, ne ofrojmë ndihmën juridike falas vetëm me këshilla juridike, duke pohuar se Këshilli Gjyqësor i Kosovës në ndihmë juridike falas sipas detyrës zyrtare bën angazhimin e avokatëve për veprat penale të dënueshme mbi 8 vjet kurse në bazë të ligjit për ndihmë juridike falas, ne jemi të obliguar të angazhojmë avokat edhe për kategori të tjera që kanë dënime më të vogla, por që i plotësojnë kriteret e ligjit për Ndhimë Juridike Falas.

Vetëm për angazhimin e avokatëve në lëmin civile dhe administrative, ne shpenzojmë buxhet 70-80 mijë euro në vit, kurse vetëm 10 për qind të rasteve referohen nga avokatët, kurse 90 për qind të rasteve të tjera zgjidhen dhe përfundojnë me veprime nga zyrtarët profesionalë të ANJF-së.

Gashi theksoi se duke ju referuar viteve paraprake, në vitin 2016 janë zgjidhur 3046 raste për arsye se janë mbyllur zyrat e UNDP-së dhe mbetëm vetëm me 5 zyra. Ndërsa tash me 7 zyra, tha jemi konsoliduar mirë dhe kemi buxhet të mjaftueshëm, por në angazhim të avokatëve vetëm për lëmine civile dhe eventualisht për fushë administrative.

Gashi tha se duhet të rifunksionalizohet edhe klinika mobile, ku kostoja e saj është 16 mijë euro në vit me një zyrtar dhe një shofer.

Kryetarjtha se Agjencia për Ndhimë Juridike Falas është shumë e rëndësishme duke e marrë parasysh në raport me varfërinë dhe papunësinë në Republikën e Kosovës, që në mungesë të mjeteve qytetarët drejtohen tek ju.Znj. Haxhiu paraqiti shqetësim se si institucionet qeveritare e kanë lënë pa buxhet këtë agjenci për shkak se çdo vit që ju raportoni keni probleme të mëdha me mungesë të buxhetit. Mandatin e kaluar jemi munduar që të kontribuojmë në buxhet shtesë për agjencinë, mirëpo kjo nuk varet shumë nga ky komision, sepse shumë nga amendamentet tona nuk janë përkrahur. Znj. Haxhiu pyeti se a keni ndonjë mekanizëm të kontrollit të avokatëve,sepse shumë nga avokatët nuk janë në dijeni për rastin që përfaqësojnë, qoftë në atë civil, apo në atë penal dhe, a kanë bërë ndonjë vlerësim se sa nga këto raste, sidomos në lëmin penale, janë në favor të rasteve që ju i mbron.

Bilall Sherifi pyeti se si e vlerësoni se kush e gëzon këtë të drejtë kushtetuese për ndihmë juridike falassepse nëse arrimë të krijojmë mekanizma se kush ka këtë të drejtë ligjore, që të gëzojë këtë të drejtë atëherë edhe ju do të keni buxhet më shumë dhe nuk do të abuzohet në lidhje me këtë drejtë nëse na mungojnë mekanizmat për kontroll se kujt i takon apo kujt nuk i takon.

Hajdar Beqa tha se është një raport i mirë dhe e shoh si shumë të arsyeshme kërkesën tuaj për mbështetje financiare, ku ne, si deputetë, mund të kontribuojmë për t'i ngritur shqetësimet e juaja

për mbështetje financiare. Gjithashtu e shoh si neglizhencë të Ministrisë së Administratës Publike që nuk ju është siguruar një objekt publik në Prishtinë, por qëndroni ende në një objekt me qira dhe po ashtu a ka strategji për zhvillim dhe avancim të mëtutjeshëm të Agjencisë për ndihmë juridike falas. Po ashtu edhe znj. Haxhiu tha se duhet t'i dërgohet një shkresë edhe Komunës së Prishtinës, edhe MAP për t'i siguruar një objekt në Prishtinë Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas.

Ramadan Gashi duke ju përgjigjur pyetjeve tha se çdo vit e bëjmë kërkesën në MAP për kalim në objekte publike në Prishtinë, ku na është thënë se kur të na vijë rasti do t'ju sistemojmë, ndërsa në komunën të Prishtinës nuk kemi bërë kërkesë. Z. Gashitheksoi se për shkak të buxhetit të limituar që kemi në lëmin penale, ne ofrojmë ndihmën juridike falas vetëm me këshilla juridike. Në jetën civile dhe administrative që kemi angazhuar avokatët kemi dy vjet që i kemi obliguar për suksesin dhe mos suksesin e tyre dhe në vitin 2016 kanë qenë, 291 raste dhe nga këto 38 raste që janë zgjidhur 37 kanë qenë në favor të palës dhe një nuk ka qenë favor të palës. Ligji i përcakton kriteret se kush duhet të ketë ndihmë juridike falas të cilat janë kriteri kualifikues, financiar dhe juridik. Kriteri financiar këtu është i rëndësishëm, ku ndahet në primare dhe sekondare. Ndhimë juridike primare i afrohet personave të cilët përfitojnë të drejtën në ndihmë sociale, ku bëjnë pjesë personat me kartonin e ndihmës sociale, pensionistët dhe grupet e marginalizuara.

Pas diskutimeve, *kryetarja konstatoi se Komisioni njëzëri vendosi që Kuvendit t'ia paraqesë këtë:*

R e k o m a n d i m

Të miratohet Raporti i Punës së Agjencisë për Ndhimë Juridike Falas për vitin 2016.

4. Propozimi i anëtarit në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të Dënuarve dhe ish të Përndjekurve Politikë

Kryetarja propozoi që personi më i denjë për të qenë në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish të përndjekurve Politikë është z. Bilall Sherifi dhe kërkoi përkrahjen e anëtarëve të komisionit.

Kryetarja konstatoi se komisioni njëzëri mori këtë:

V e n d i m

Deputeti Bilall Sherifi caktohet anëtarët në Komisionin Qeveritar për Njohjen e Statusit të ish- të dënuarve dhe ish të përndjekurve politikë.

5. Formimi i grupit punues për Rregulloren e Kuvendit

Kryetarja konstatoi se Komisioni një zëri nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit punues për hartimin- ndryshimin e Rregullores së Kuvendit

1. Formohet Grupi i punës në përbërje:

Agim Aliu, kryesues
Korab Sejdiu, anëtar
Albulena Haxhiu, anëtare
Shkumbin Demaliaj, anëtar
Bilall Sherifi, anëtar
Bahrim Shabani, anëtar dhe
JelenaBontiq, anëtare.

6. Formimi i grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsion

Kryetarjakonstatoi se komisioni njëzëri nxori këtë:

V e n d i m

Për formimin e grupit punues për mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit

1.Formohet Grupi i punës në përbërje:

Albulena Haxhiu, kryesues
Arben Gashi, anëtar
Hajdar Beqa, anëtar
Shkumbin Demaliaj, anëtar
Bilall Sherifi, anëtar
Bahrim Shabani, anëtar dhe
JelenaBontiq, anëtare.

7. Diskutim lidhur me planin e punës së komisionit

Kryetarjajaparaqiti për diskutim planin e punës së komisionit për këtë vit, ku jemi bazuar në projektligjet që na kanë ardhur. Znj. Haxhiu propozoi që në muajin nëntor në plan të punës të jetë projekt –rregullorja e punës së Kuvendit dhe, po ashtu, sqaroi se në këtë plan pune nuk kemi monitorime të ligjeve për arsye se ne, si komision, nuk mund t'i adresojmë deri në muajin dhjetor dhe kërkoi nga anëtarët e komisionit të deklarohen nëse kanë ndonjë vërejtje apo sugjerim.

Meqë nuk kishte vërejtje, kryetarja konstatoi se Komisioni, e miratoi planin e punës me ndryshimet që u cekën më lart.

8. Të ndryshme

A. Ftesë ministrit të Drejtësisë për raportim në Komision lidhje me zbatimin e Marrëveshjes për Drejtësi

Kryetarja tha se duhet ta ftojë ministrin e Drejtësisë, z. Abelard Tahiri, për të diskutuar në lidhje për zbatimin e Marrëveshjes për Drejtësi dhe për çështje të tjera.

Shkumbin Demaliaj propozoi që do të ishte mirë të specifikohet qartë se për çfarë do të ftohet ministri i Drejtësisë. Po ashtu edhe z. Beqa edhe z. Sherifi u pajtua me propozimin e z. Demaliaj.

Meqë nuk pati më diskutime anëtarët e komisionit u dakorduan që të ftohet ministri i Drejtësisë duke e lënë në diskrecion të agjendës të ministrit kohën për raportim në komision.

Po ashtu u vendos që në mbledhjen e radhës, si pikë e rendit të ditës, të ftohet për raportim Agjencia për Krahësim dhe Verifikim të Pronës.

Mbledhja përfundoi në orën 15:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i komisionit.

Kryetarja e komisionit,

Albulena Haxhiu